



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/235 Nr. i faq./Br.str./No.pg 68

Date/Datum/Date 25.07.2024

Në mbështetje të nenit 12, pika 1 dhe pika 2, shkronja d), nenit 14, pika 1, nenit 17, shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.07.2024, miraton këtë:

### V E N D I M

#### Shpalljen me interes të përgjithshëm publik P -71510026-00041-1 në Zonën Kadastrale Drenoc

1. Me këtë vendim, shpallet me interes të përgjithshëm publik në ndërtesën administrative të KB Bujku Drenoc – Rahovec, Zona kadastrale Drenoc, Komuna e Rahovecit, në sipërfaqe prej 200m<sup>2</sup> (dyqind metra katror), e cila gjendet në njësinë kadastrale: P -71510026-00041-1, në vendin e quajtur *Vishe Sela – Vishe Sela*, sipas certifikatës së pronësisë: *Pasuri Shtetërore e Kosovës K.K. Rahovec - Shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve Rahovec*.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të lokalit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do të jetë: inicimi i procedurës për shpronësim dhe meremetimi i shtabit të UÇK-së.
3. Autorizohet kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, t'i ndër marrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

#### Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.235/24  
Datë:25.07.2024

